

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Seanca plenare

Seanca nr. 02-03/94

Prishtinë, më 26 janar 2005

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

PROCESVERBAL

Seancën e kryesoi Nexhat Daci, kryetar i Kuvendit të Kosovës, kurse e ndihmoi Xhavit Haliti, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 99 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kryesia ia kishte propozuar Kuvendit këtë

REND DITE:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme;
2. Fjala e kryetarit të Kosovës para deputetëve të Kuvendit;
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Inspektoratin e Tregut;
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për të Drejtat e Prestarëve të Luftës së UÇK-së;
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Prokurorinë Publike të Kosovës;
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Mbrojtjen e Dëshmitarëve;
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Mbështetjen e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme;
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Lirinë e Asocimit në OJQ;
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Sigurimet Shëndetësore;
10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Verërat;
11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Ujitjen e Tokave;
12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Përkujdesjen ndaj Kafshëve;
13. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Trashëgiminë Kulturore;
14. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Teatrin;

15. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Miratimin e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës dhe të Përvetësimeve për periudhën kohore prej 1 janarit deri më 31 dhjetor 2005;
16. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Produktet e Ndërtimit;
17. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave;
18. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.2003/2 “ Për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjëseve” dhe
19. Shqyrtimi i propozimvendimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e kryetarit të Komisionit për Prokurimin Publik.

Kryetari propozoi që rendit të ditës t'i shtohet edhe propozimi i Qeverisë së Kosovës për zgjedhjen e z. Sllavisha Petkoviq, ministër i Ministrisë për Komunitete dhe Kthim. Kuvendi e miratoi propozimin e kryetarit.

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme

Procesverbali i seancës së mëparshme u miratua pa vërejtje.

Në fillim të seancës, **Hashim Thaçi**, në emër të PDK-së kërkoi që kryetari Kosovës të paraqet raport mbi gjendjen e përgjithshme në vend dhe pastaj të hapet diskutimi parlamentar lidhur me të.

Ai kërkoi që si çështje urgjente të shqyrtohet procesi i decentralizimit dhe Kuvendi të nxjerr konkluzione lidhur me këtë proces.

Kryetari tha se nuk është paraparë të hapet debat për fjalën e kryetarit të Kosovës, kurse çështja e decentralizimit do të shqyrtohet në seancën e radhës.

Kryetari e ftoi kryetarin e Kosovës ta paraqet fjalimin vjetor para Kuvendit të Kosovës.

Kryetari i Kosovës, dr. Ibrahim Rugova - Ky fjalim do të ketë karakter solemn dhe do të paraqesë gjendjen dhe vizionin për kombin në fillim të vitit.

Kosova pas afër gjashtë vjetësh ka pasur një progres të madh në të gjitha fushat e zhvillimit të saj. Ky progres ka qenë në ngritje e sipër edhe gjatë vitit të shkuar. Do konstatuar se viti 2004 do të hyjë në analet e Kosovës për mbajtjen me sukses të zgjedhjeve të dyta nacionale. Në këto zgjedhje u dëshmuar një kulturë e lartë politike e shtetërore e të gjithë qytetarëve të vendit si dhe e partive politike e pjesëmarrësve të tjerë në këtë proces demokratik. Njëherësh ishte i rëndësishëm edhe krijimi me kohë i institucioneve të reja nacionale, sipas procedurës demokratike, që u vlerësua pozitivisht nga qytetarët dhe bashkësia ndërkombëtare.

Kuvendi i Kosovës ka kryer një punë të madhe në miratimin e shumë ligjeve themelore, deklaratave e rezolutave të ndryshme në të mirë të Kosovës dhe ka krijuar një frymë demokratike të punës së vet.

Qeveria e Kosovës me të gjitha ministrinë ka arritur të krijojë një përvojë ekzekutive në interes të vendit e të qytetarëve. Duke u mbështetur në programin e Qeverisë së re, që është mjaft ambicioz, jam i bindur se do të kemi një efikasitet më të madh.

Presidenti i Kosovës ka ushtruar një ndikim pozitiv në funksionimin e institucioneve të vendit, duke dhënë sugjerime e iniciativa të ndryshme. Çështje qendrore ka qenë qëndrueshmëria e stabiliteti politik e shtetëror dhe po ashtu ka bërë një përfaqësim të unitetit të popullit në vend dhe të interesave nacionale jashtë. Presidenti do të forcojë rolin e tij unifikues dhe përfaqësues në periudhën e ardhshme.

Fusha e ekonomisë ka treguar një ngritje të qëndrueshme, sidomos sektori privat, i cili është dinamizuar me procesin e privatizimit.

Gjendja e sigurisë ka pasur një konsolidim të vazhdueshëm.

Arsimi ka vazhduar procesin e reformave dhe është në fazën e konsolidimit të qëndrueshëm, që t'u përgjigjet nevojave të zhvillimit ekonomik e demokratik të vendit.

Në fushën e shëndetësisë do të kemi një angazhim më të madh, sidomos në vendosjen e mjekësisë së lartë dhe specializimin e ekspertëve për këtë punë.

Në planin social është treguar një kujdes ndaj grupeve të ndryshme sociale në çështjen e punësimit dhe të ndihmës.

Në sektorin e bujqësisë duhet të demonstrojmë një angazhim më të madh. Mbetet detyrë që të fillojmë subvencionimin e projekteve të ndryshme që do të shtonin prodhimin dhe cilësinë.

Kujdesi ndaj ambientit ka qenë më i shtuar në nivel të pushtetit lokal dhe të atij nacional.

Në të gjitha fushat e sportit ka pasur progres.

Ne e përshëndesim suksesin e disa federatave sportive që u anëtarësuan në federatat ndërkombëtare dhe në ato evropiane.

Në planin e kulturës është treguar një angazhim i mirë për trashëgiminë kulturore.

Angazhim më të madh do të bëjmë për diasporën kosovare në SHBA dhe në Evropë, për t'i mbajtur lidhjet me atdheun dhe t'u krijojmë më shumë lehtësime për investime.

Në fushën e punës së gjykatave ka pasur një progres të mirë dhe me krijimin e Ministrisë së drejtësisë do të kishim më shumë efikasitet dhe më shumë kujdes për këtë degë të shtetit.

Në vitin që kemi hyrë do të kemi një rritje më të madhe të progresit të vendit tonë, sepse kemi krijuar një bazë të qëndrueshme shtetërore të aftë për zhvillim të mëtutjeshëm.

Njëherësh do theksuar se angazhim të fuqishëm do të bëjmë në zgjidhjen e problemit energjetik në vend, që është bazë për zhvillimin ekonomik.

Në zhvillimet e brendshme do të vazhdojmë të angazhohemi më shumë në integrimin e grupeve etnike, apo të minoriteteve, në shoqërinë dhe në shtetin e Kosovës, si dhe për mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të tyre.

Është koha që Kosova të ketë mundësi të përfaqësimit diplomatik në disa vende evropiane dhe në SHBA dhe në vende të tjera.

Një angazhim të vazhdueshëm do të bëjmë në vlerësimin dhe përmbushjen e standardeve prioritare për integrim në strukturat evropiane dhe euroatlantike, siç janë: stabiliteti politik, mbrojtja dhe garantimi i minoriteteve, si dhe reforma e pushtetit lokal, që do të bëhet mbi baza vertikale dhe jo mbi baza etnike.

Ne do të punojmë dhe insistojmë që të bëhet njohja e drejtpërdrejtë e pavarësisë së Kosovës, në kufijtë aktualë, nga SHBA dhe nga BE.

Fjalimi i plotë i kryetarit të Kosovës i është bashkangjitur transkriptim.

Kryetari dha pauzë pesëmbdhetëminutshe.

3. Zgjedhja e ministrit për Komunitete dhe Kthime

Kryeministri, Ramush Haradinaj, në emër të Qeverisë së Kosovës e propozoi z. Sllavisha Petković për ministër të Ministrisë për Komunitete dhe Kthime.

Gani Koci, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, tha se nuk e mbështesin propozimin e kryeministrit për zgjedhjen e z. Sllavisha Petović ministër për Komunitete dhe Kthime, ngase kishin vërejtje në biografinë e tij.

Kryetari e hodhi në votë propozimin e kryeministrit. Rezultati ishte si vijon:

Për-----66;
Kundër-----28;
Abstenime—5.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, zgjodhi z. Sllavisha Petković ministër të Ministrisë për Komunitete dhe Kthime.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Inspektoratin e Tregut

Kryetari e ftoi sponsoruesin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Veton Surroi, në emër të ORË-së, bëri vërejtje për projektligjet e propozuara nga Qeveria, që nuk e kanë shpjegimin e kostos për implementimin e tyre. Ai propozoi që në seancën e sotme të mos shqyrtohet asnjë Projektligj, pos Projektligjit për buxhet, i cili është me urgjencë për funksionimin e Qeverisë dhe të Kuvendit.

Kryetari tha se është përfundim i Kryesisë që këto projektligje të shqyrtohen në parim, kurse të kërkohet nga Qeveria t'ia bashkangjes deklaratat financiare të gjitha projektligjeve të proceduara para shqyrtimit të dytë të tyre.

Ministri, **Bujar Dugolli**, në emër të Qeverisë së Kosovës, arsyetoi nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri, si dhe qëllimin dhe objektivat që do të realizohen me zbatimin e tij.

Në vazhdim, ministri Dugolli e shpjegoi strukturën e këtij projektligji.

Projektligji përmban 39 nene dhe është i strukturuar në 5 kapituj.

Në kapitullin e parë janë dhënë dispozitat e përgjithshme, me të cilat përcaktohen punët e mbikëqyrjes inspektuese, si dhe autorizimet e inspektorëve të tregut.

Kapitulli i dytë rregullon mbikëqyrjen e drejtpërdrejt të zbatimit të ligjit dhe të akteve tjera ligjore, të plotësimit të kushteve dhe mënyrën e ushtrimit të veprimtarive afariste nga personat fizikë dhe juridikë.

Kapitulli i tretë rregullon mbikëqyrjen inspektuese. Inspektori i tregut është i autorizuar, të kontrolloj lokalit afarist, mallin, instalimet, pajisjet, librin e afarizmit dhe të evidencës, lejet si dhe dokument tjera afariste të cilat mundësojnë inspektimin dhe veprimtarinë afariste të personit fizik dhe juridik.

Kreu i katërt parasheh dispozitat ndëshkimore duke paraparë dënime me gjobë, për rastet, kur personi përgjegjës i personit juridik shkel rregullat e parapara me ligj.

Kreu i pestë parasheh dispozitat kalimtare dhe të fundit, në të cilat parashihen që inspektorët që kanë ushtruar mbikëqyrjen inspektuese, sipas dispozitave ligjore që kanë qenë në fuqi, deri në miratimin e këtij ligji, obligohen që mbikëqyrjen ta ushtrojnë sipas dispozitave të këtij ligji, prej ditës së hyrjes në fuqi të tij.

Në fund, ministri Dugolli i ftoi deputetët e Kuvendit ta miratonin këtë projektligj.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Bajrsuh Xhemajli, Fatmir Rexhepi, Gjylnaze Sylja, Teutë Sahatxhiu, Mahir Jakxhillar, Alush Gashi, Berat Luzha, Naxhije Doçi dhe Remzije Nimani**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votë këtë projektligj. Rezultati ishte si vijon:

Për-----61;

Kundër----- 21;

Abstenime---- 0.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, e **miratoi** në parim Projektligjin për Inspektoratin e Tregut.

Kuvendi i ngarkoi komisionet kryesore dhe Komisionin për Ekonomi, Tregti dhe Industri – Komision raportues - ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda tri javësh dhe t’ia paraqesin Kuvendit raportet me rekomandime për miratim.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për të Drejtat e Pjesëtarëve të Luftës së UÇK-së, të Familjeve të Dëshmorëve dhe të Viktimave Civile të Luftës

Kryetari e ftoi sponsoruesin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri Ahmet Isufi, në emër të Qeverisë së Kosovës, arsyetoi nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri, si dhe qëllimin dhe objektivat që do të realizohen me zbatimin e tij.

Në vazhdim, ministri Isufi e shpjegoi strukturën e këtij projektligji.

Projektligji përbëhet nga 6 kapituj.

Kapitulli i parë përfshinë dispozitat themelore që rregullojnë qëllimin, fushëveprimin dhe kuptimin e shprehjeve në këtë Projektligj.

Kapitulli i dytë përfshinë dispozitat për të drejtat e përcaktuara me këtë Projektligj që i rregullojnë të drejtat themelore, përparësitë në vendosje dhe strehim si dhe të drejtat e veçanta të kategorive që janë të përfshira në këtë projektligj.

Kapitulli i tretë përfshinë dispozitat për realizimin e të drejtave që rregullojnë pensionin familjar, pensionin invalidor personal, pensionin invalidor familjar, pensional invalidor të luftës dhe pensionin invalidor familjar të viktimave civile të luftës.

Kapitulli i katërt përfshinë dispozitat që e rregullojnë procedurën e realizimit të të drejtave të kategorive që janë të përfshira në këtë Projektligj.

Kapitulli i pestë përmban dispozitat ndëshkuese dhe

Kapitulli i gjashtë përmban dispozitat përfundimtare dhe kalimtare.

Në fund, ministri Isufi i ftoi deputetët e Kuvendit ta miratonin këtë projektligj.

Pas arsyetimit të këtij projektligji nga ministri Isufi, kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë edhe këta deputetë: **Alush Gashi, Jakup Krasniqi, Mevlyde Dreshaj, Sabri Hamiti, Sokol Bashota, Berat Luzha, dhe Fadil Geci**, që i janë bashkangjitur transkriptim.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votë këtë projektligj. Rezultati ishte si vijon:

Për-----80;

Kundër----- 1;

Abstenime---- 1.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës e miratoi në parim Projektligjin për të Drejtat e Pjesëtarëve të Luftës së UÇK-së, të Familjeve të Dëshmorëve dhe të Viktimave Civile të Luftës.

Kuvendi i ngarkoi komisionet kryesore dhe Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale – Komision raportues - ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda tri javësh dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportet me rekomandime për miratim.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Prokurorinë Publike të Kosovës

Kryetari e ftoi sponsoruesin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Kryeministri Ramush Haradinaj, në emër të Qeverisë së Kosovës, arsyetoi nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri, si dhe qëllimin dhe objektivat që do të realizohen me zbatimin e tij.

Projektligji sistemohet në shtatë kapituj dhe përfshin gjithsej 65 nene.

Në fillim trajtohen çështjet e përgjithshme, që u referohen prokurorive publike, kurse në vazhdim trajtohen çështjet që lidhen me organizimin dhe me funksionimin e prokurorive publike.

Statusi dhe përkrahja e prokurorit publik, marrëdhëniet dhe bashkëpunimi me institucionet përkatëse, me publikun dhe në fund projektligji i përfshin dispozitat kalimtare dhe ato të fundit.

Vlerësojmë se me këtë projektligj mundësohet organizimi dhe funksionimi efektiv i Prokurorive Publike në Kosovë. Prandaj, ju propozojmë ta miratoni këtë projektligj.

Pas arsyetimit të këtij projektligji nga kryeministri, kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Fatmir Sejdiu, Nerxhivane Dauti, Bajram Kosumi, Mahir Jakxhillar, Nekibe Kelmendi, Emrush Xhemajli, Ramadan Kelmendi, Hydajet Hyseni, Fadil Geci dhe Sanije Alaj**, që i janë bashkangjitur transkriptim.

Kryetari e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për -----75;
Kundër----- 1;
Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës e miratoi në parim Projektligjin për Prokurorinë Publike.

Kuvendi i ngarkoi komisionet kryesore dhe Komisionin për Gjyqësi, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese – Komision raportues - ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda tri javësh dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportet me rekomandime për miratim

Kryetari dha pauzëdreke.

Pas pauzës, seancën e kryesoi Xhavit Haliti, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Mbrojtjen e Dëshmitarëve

Kryesuesi e ftoi sponsoruesin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Zëvendëskryeministri, Adem Salihaj, në emër të Qeverisë së Kosovës, arsyetoi nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri.

Ky projektligj ka për qëllim të promovojë standardet e pranuar ndërkombëtare, kushtet, masat mbrojtëse dhe veprimet e ofrimit të mbrojtjes së dëshmitarëve të kërcuar dhe të rrezikuar në procedurën penale, të cilën e zhvillojnë prokuroritë, gjykatat dhe njësia për mbrojtje të dëshmitarëve për rastet të veprave penale të parashikuara me këtë projektligj. Projektligji synon të vendos një kornizë adekuate ligjore dhe të vetme për rregullimin dhe funksionimin e njësisë për mbrojtje të dëshmitarëve, duke përfshirë këtu mbikëqyrjen e funksionimit të saj, nga ana e gjykatës si dhe çështjen e bashkëpunimit me organet e rendit.

Në fund, zëvendëskryeministri i ftoi deputetët e Kuvendit ta miratonin këtë projektligj.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Fatmir Sejdiu, Gani Koci, Naim Maloku, Xhezair Murati, Hydajet Hyseni, Alush Gashi, Fadil Geci dhe Jakup Krasniqi**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Kryesuesi e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për -----76;
Kundër----- 1;
Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi: Kuvendi i Kosovës e **miratoi në parim** Projektligjin për Mbrojtjen e Dëshmitarëve.

Kuvendi i ngarkoi komisionet kryesore dhe Komisionin për Gjyqësi, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese – Komision raportues - ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda tri javësh dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportet me rekomandime për miratim

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Mbështetjen e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme

Kryesuesi e ftoi sponsoruesin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit. Ministri, **Bujar Dugolli**, në emër të Qeverisë së Kosovës, arsyetoi nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri, si dhe qëllimin dhe objektivat që do të realizohen me zbatimin e tij.

Në vazhdim, ministri Dugolli e shpjegoi strukturën e këtij projektligji.

Projektligji përbëhet gjithsej 27 nene ndahet në gjashtë kapituj.

Në kreun e parë janë përfshirë dispozitat e përgjithshme të këtij projektligji, masat dhe politikat qeveritare për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Kreu i dytë përfshinë programet për nxitjen e krijimit dhe zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, masat themeluese dhe zhvillimin e tyre, si dhe përfituesit e programit të mbështetjes së këtyre ndërmarrjeve.

Kreu i tretë rregullohen fushat e mbështetjes financiare për nxitjen e veprimtaritë së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, sigurinë dhe ndarjen e mjeteve financiare, si dhe mënyrën e kreditimit.

Kreu i katërt parashihen programet për mbështetjen dhe zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, si dhe programet zhvillimore.

Kreun e pestë parasheh themelimin e Agjencisë për Mbështetjen e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme.

Në kreun e gjashtë parashihen dispozitat përfundimtare, me të cilat përcaktohet obligimi i institucioneve përkatëse që do të nxjerrin aktet e nevojshme nënligjore për të siguruar zbatimin e këtij projektligji.

Në fund, ministri Dugolli i ftoi deputetët e Kuvendit ta miratonin këtë projektligj.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Fatmir Rexhepi, Sala Berisha, Gjylnaze Syla, Xhezair Murati, Besa Gaxheri, Hajredin Hyseni, Xhevdet Neziraj, Behxhet Brajshori, Lutfi Zharku dhe Ibush Jonuzi**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Kryesuesi e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për -----74;
Kundër----- 0;
Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi: Kuvendi i Kosovës e **miratoi në parim** Projektligjin për Mbështetjen e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme. Kuvendi i ngarkoi komisionet kryesore dhe Komisionin për Ekonomi, Tregti dhe Industri – Komision raportues - ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda tri javësh dhe t’ia paraqesin Kuvendit raportet me rekomandime për miratim.

Kryesuesi e deklaroi seancën të mbyllur në orën 16:00.

E enjte, 27 janar 2005

Vazhdim i seancës

Seancën e kryesoi Nexhat Daci, kryetar i Kuvendit të Kosovës.

Në fillim të seancës, **Alush Gashi**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, kërkoi që në seanca plenare të jetë e pranishme tërë Qeveria, si dhe ministrat të jenë të pranishëm në debatet e komisioneve përkatëse, kur shqyrtohen projektligjet.

Jakup Krasniqi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, kërkoi që projektligjet, para deputetëve të Kuvendit, t’i arsyetojnë kryeministri dhe ministrat, e jo zëvendëskryeministri dhe zëvendësministrat.

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Lirinë e Asocimit në OJQ

Kryesuesi e ftoi sponsoruesin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Zëvendëskryeministri, Adem Salihaj, në emër të Qeverisë së Kosovës, arsyetoi nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri.

Në vazhdim, zëvendëskryeministri Salihaj e shpjegoi strukturën e këtij projektligji.

Projektligji është strukturuar në 5 kapituj.

Kapitulli i parë përfshin dispozitat që rregullojnë fushëveprimin dhe përkufizimet e termave të përdorura në këtë projektligj, lira e asocimit, mosshpërndarjen e të ardhurave neto dhe fitimit dhe kufizimi i përfitimeve speciale.

Kapitulli i dytë përfshin dispozitat me të cilat janë definuar çështjet që kanë të bëjnë me nocionin e shoqatave, fondacioneve dhe organizatave tjera në Kosovë. Themelimin e tyre, aspektet e asocimit të OJQ-ve dhe atyre ndërkombëtare, statusin ligjor dhe regjistrin publik të OJQ-ve.

Kapitulli i tretë përfshin dispozitat me të cilat rregullohen çështjet që kanë të bëjnë me udhëheqjen e brendshme të shoqatave, fondacioneve, konfliktin e interesave dhe detyrimin në lojalitet, ndalimin e mbledhjes së fondeve, fushatave të mbështetjes së kandidatëve dhe partive politike, si dhe çështjen e pasurisë dhe mjeteve të OJQ-ve. Kapitulli i katërt përfshin dispozitat me të cilat rregullohet statusi për fituesit publik të OJQ-ve dhe obligimet për raportin financiar dhe të aktivitetit të OJQ-ve me status të përfituesit publik.

Kapitulli i pestë përfshin dispozitat me të cilat rregullohet mënyra e zbatimit të këtij ligji dhe hyrja në fuqi e këtij Ligji.

Në fund, zëvendëskryeministri Salihaj i ftoi deputetët e Kuvendit ta miratonin këtë projektligj.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Sabri Hamiti, Sokol Bashota, Naser Osmani, Gjylnaze Sylaj, Nekibe Kelmendi, Mahir Jakxhillar, Gjergj Dedaj, Numan Baliq, Qibrije Hoxha, Gjylshene Berisha, Fadil Geci, Sanije Alaj dhe Bujar Dugolli**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Kryetari e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për -----75;
Kundër----- 0;
Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës e **miratoi në parim** Projektligjin për Lirinë e Asocimit në OJQ.

Kuvendi i ngarkoi komisionet kryesore dhe Komisionin për Gjyqësi, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese – Komision raportues - ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda tri javësh dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportet me rekomandime për miratim.

Me kërkesë të kryetarit, **Kuvendi mbajti një minutë heshtje**, në shenjë kujtimi të gjashtëdhjetvjetorit për viktimat e Holokaustit dhe të viktimave nga fatkeqësia natyrore të Tsunamit.

10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Sigurimet Shëndetësore

Kryetari e ftoi sponsoruesin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri Sadik Idrizi, në emër të Qeverisë së Kosovës, arsyetoi nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri.

Osnovne odredbe određuju zdravstveni sistem osiguranja, koje se organizuje i primenjuje kao osnovno zdravstveno osiguranje kao i zdravstveno privatno osiguranje. Svi građani Kosova kao i strani radnici koji rade na Kosovu obuhvaćeni su zdravstvenim sistemom osiguranja.

Osnovno zdravstveno osiguranje je obavezno, prava i obaveza osiguranika u osnovnom zdravstvenom sistemu oslanjaju se na cela reciprociteta i solidarnosti prema uslovima predviđenim ovim Zakonom.

Sredstva za osnovno zdravstveno osiguranje prikupljaju se uplatom dobrinosa radnika, poslodavaca i drugih obveznika kao i iz drugih izvora predviđenih zakonom.

Osnovno zdravstveno osiguranje provodi Kosovski fond za zdravstveno osiguranje, dok nadzor rada fonda po zakonu vrši Ministarstvo zdravstva.

Privatna zdravstvena osiguranja primenjuju se kao dopunska dobrovoljna osiguranja. Prava iz osnovnih zdravstvenih osiguranja obuhvataju prava na korišćenje usluga iz paketa usluga osnovne zdravstvene, nege koja se pruža na nivou primarne zdravstvene

zaštite, sekundarne i tercijalne bolničke zaštite, sekundarne i tercijalne van bolnice kao i zdravstvene zaštite van Kosova.

Sredstva za osnovno zdravstveno osiguranje obezbeđuju se od uplata zaposlenih i poslodavaca, uplata zemljoradnika, aktivnih ekonomskih lica itd. Prikupljanja sredstava za fond obezbeđuje preko Ministarstva privrede i finansije.

Në fund, ministri Idrizi i ftoi deputetët e Kuvendit ta miratonin këtë projektligj.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhurm me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Naim Jerliu, Teutë Hadri-Ramadani, Zylfije Hundozi, Xhezair Murati, Fehmi Vula, Zahrije Isufi, Numan Baliq, Nurishahe Hulaj dhe Remzije Nimani**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Kryetari e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për -----75;

Kundër----- 1;

Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës e **miratoi në parim** Projektligjin për Sigurimet Shëndetësore.

Kuvendi i ngarkoi komisionet kryesore dhe Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale – Komision raportues - ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda tri javësh dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportet me rekomandime për miratim.

Kryetari dha pauzë pesmbdhetëminutshe.

Pas pauzës, seancën e kryesoi **Xhavit Haliti**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Produktet e Ndërtimit

Kryesuesi e ftoi sponsoruesin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri **Bujar Dugolli**, në emër të Qeverisë së Kosovës, arsyetoi nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri, si dhe qëllimin dhe objektivat që do të realizohen me zbatimin e tij.

Në vazhdim, ministri Dugolli e shpjegoi strukturën e këtij projektligji.

Projektligji për produktet ndërtimore është i strukturuar në nëntë (9) kapituj.

Kapitulli i parë përfshinë dispozitat e përgjithshme për kufizimin e nocioneve themelore dhe kushtet për përdorim dhe ofrimin në tregun e produkteve.

Kapitulli i dytë përcakton se produktet e ndërtimit mund të dalin në treg vetëm në qoftë se janë të përshtatshme për përdorim, në përputhje me standardet e Kosovës, përkatësisht rregullat teknike të tyre.

Kapitulli i tretë rregullon miratimin teknik të përshtatshmërisë për përdorimin e një produkti për një qëllim të synuar, bazuar në mbështetjen e kërkesave themelore për punët ndërtimore.

Kapitulli i katërt parasheh vlerësimin dhe vërtetimin e konformitetit të produkteve ndërtimore dhe kërkesat specifike teknike.

Kapitulli i pestë përcakton mundësinë e përfshirjes e një institucioni kompetent për kryerjen e testeve dhe provave për produktet ndërtimore, sipas kushteve që parasheh ligji.

Kapitulli i gjashtë parasheh procedurat e veçanta në mungesë të specifikave teknike të parashikuara me këtë projektligj e deri në adaptimin e tyre.

Kapitulli i shtatë përcakton masat ndëshkimore në rast të mos zbatimit të Projektligjit, duke përcaktuar të drejtën në ankesës së vendimit të marrin në zbatim të këtij ligji dhe akteve tjera përcjellëse të tij.

Kapitulli i tetë përcakton të drejtën e ankesës ndaj gjobave, të shqiptuara me vendim të inspektionit të produkteve të ndërtimit ose në rast të heshtjes së autoriteteve inspektuese brenda afatit të përcaktuar me ligj.

Kapitulli i nëntë përmban dispozitat kalimtare dhe të fundit, në të cilat parashihen obligimet e institucioneve që derisa specifikat teknike që parashihen në këtë ligj.

Në fund, ministri Dugolli i ftoi deputetët e Kuvendit ta miratonin këtë projektligj.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhurm me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Alush Gashi, Bajrush Xhemajli, Xhevdet Neziri dhe Fatmir Rexhepi**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Kryesuesi e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për -----78;

Kundër----- 0;

Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi: Kuvendi i Kosovës, njëzëri e **miratoi në parim** Projektligjin për Produktet e Ndërtimit.

Kuvendi i ngarkoi komisionet kryesore dhe Komisionin për Ekonomi, Tregti dhe Industri – Komision raportues - ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda tri javësh dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportet me rekomandime për miratim.

12. Shqyrtimi i parë të Projektligjit për Verërat

Kryesuesi e ftoi sponsoruesin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Zëvendësministri **Tomë Hajdaraj**, në emër të Qeverisë së Kosovës, arsyetoi nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri, si dhe qëllimin dhe objektivat që do të realizohen me zbatimin e tij.

Në vazhdim, zëvendësministri Hajdaraj e shpjegoi strukturën e këtij projektligji.

Çështjet kryesore që i rregullon ky projektligj janë:

Përkufizimet e nocioneve të përdorura, prejardhja gjeografike dhe autoritetet kompetente për zbatimin e dispozitave të caktuara të Ligjit.

Aktivitetet e ndërmarra për prodhimin e rrushit dhe përpunimin, ripërpunimin dhe proceset teknologjike të verës dhe produkteve të verës.

Prodhimin e verërave cilësore të bazuar në kufizimin e zonave, klasifikimin e verërave të përshtatshme për prodhim të verërave cilësore, teknologjisë së përdoruar, fortësisë minimale alkoolike, kufizimin e rendimentit dhe karakteristikat organoleptike.

Rajonizimin dhe ndarjen e territoriale gjeografike në bazë të kushteve të ngjashme klimatike dhe tokësore si dhe rajonizimin e varieteteve të hardhisë sipas këtyre kushteve.

Klasifikimin e verërave në bazë të ngjyrës, përmbajtjes së sheqerit, vetive organoleptike, prejardhjes gjeografike dhe vlerësimin si dhe testimin e verërave.

Aktivitetet dhe procedurat e etiketimit të verërave.

Praktikat dhe proceset enologjike, përmbajtjen e sulfurit dhe acideve avulluese, kufijtë e pasurimit, acidimit dhe deacidimit.

Kushtet nën të cilat verërat dhe produktet e tjera mund të vihen në shitje, distribuohen, mbushen dhe etiketohen.

Procedurat e inspektimit, autorizimet e inspektorit, marrja dhe dërgimi i mostrave në institutin e autorizuar për analizë, si dhe

Dispozitat ndëshkuese dhe përfundimtare.

Në fund, ministri Hajdaraj i ftoi deputetët e Kuvendit ta miratonin këtë projektligj.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Fetah Berisha, Xhelal Canziba, Gjylnaze Syla, Rifat Krasniq, Naxhije Doçi dhe Ragip Zekolli**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Kryesuesi e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për -----78;

Kundër----- 0;

Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi: Kuvendi i Kosovës, njëzëri e **miratoi në parim** Projektligjin për Verërat. Kuvendi i ngarkoi komisionet kryesore dhe Komisionin për Bujqësi. Pylltari dhe Zhvillim Rural– Komision raportues - ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda tri javësh dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportet me rekomandime për miratim.

Kryesuesi dha pauzëdreke.

Pas pauzës, seancën e kryesoi Nexhat Daci, Kryetar i Kuvendit të Kosovës.

12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Ujitjen e Tokave

Kryesuesi e ftoi sponsoruesin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Zëvendësministri **Tomë Hajdaraj**, në emër të Qeverisë së Kosovës, arsyetoi nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri, si dhe qëllimin dhe objektivat që do të realizohen me zbatimin e tij.

Në vazhdim, zëvendësministri Hajdaraj e shpjegoi strukturën e këtij projektligji.

Çështjet kryesore që i rregullon ky projektligj janë:

Organizimi dhe administrimi i ujitjes dhe kullimit të tokës bujqësore në Kosovë;
Kompetencat e MBPZHR lidhur me ujitjen;
Transfer i përgjegjësive prej sistemeve të ujitjes nga kompanitë në Shoqata dhe Federata të ujitjes;
Formimin dhe regjistrimin e Shoqatave të përdoruesve të ujit dhe federatave, organizimin e tyre, tarifat e ujit dhe çështjet tjera lidhur me ujitjen e tokave bujqësore.
Me qëllim të shfrytëzimit të sistemeve të ujitjes dhe sigurimit të ujitjes së tokës bujqësore, e cila do të ndikonte në rritjen e prodhimit, propozojmë ta miratoni këtë projektligj.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Zylfije Maloku, Afrim Arzuallxhiu dhe Naim Maloku**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Kryetari e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për -----66;
Kundër----- 0;
Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës, njëzëri e **miratoi në parim** Projektligjin për Ujitjen e Tokave. Kuvendi i ngarkoi komisionet kryesore dhe Komisionin për Bujqësi. Pyltari dhe Zhvillim Rura – Komision raportues - ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda tri javësh dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportet me rekomandime për miratim.

14. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Përkujdesjen ndaj Kafshëve

Kryetari e ftoi sponsoruesin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Zëvendësministri **Tomë Hajdaraj**, në emër të Qeverisë së Kosovës, arsyetoi nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri, si dhe qëllimin dhe objektivat që do të realizohen me zbatimin e tij.

Në vazhdim, zëvendësministri Hajdaraj e shpjegoi strukturën e këtij projektligji.

Projektligji përmban shtatë kapituj: Dispozitat e përgjithshme; Aktivitetet e përkujdesjes ndaj kafshëve; Metodatat e mbarsimit të kafshëve; Mbajtjen e kafshëve rekreative; Procedurat e inspeksionit, si dhe dispozitat përfundimtare dhe ndëshkimore.

Në fund, ministri Hajdaraj i ftoi deputetët e Kuvendit ta miratonin këtë projektligj.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Isuf Sutaj, Berat Luzha, Zylfije Hundozi dhe Fadil Geci**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Kryetari e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për -----67;
Kundër----- 0;
Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës, njëzëri e **miratoi në parim** Projektligjin për Përkujdesjen ndaj Kafshëve. Kuvendi i ngarkoi komisionet kryesore dhe Komisionin për Bujqësi. Pylltari dhe Zhvillim Rural – Komision raportues - ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda tri javësh dhe t’ia paraqesin Kuvendit raportet me rekomandime për miratim.

15. Shqyrtimi i parë i Projektligji për Trashëgiminë Kulturore

Kryetari e ftoi sponsoruesin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Zëvendësministrja **Angjelina Krasniqi**, në emër të Qeverisë së Kosovës, arsyetoi nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri, si dhe qëllimin dhe objektivat që do të realizohen me zbatimin e tij.

Në vazhdim, Zëvendësministrja Angjelina Krasniqi theksoi se me këtë projektligj rregullohen trashëgimitë kulturore dhe llojet e saj. Bëhet përcaktimi i mbrojtjes dhe i ruajtjes së trashëgimisë kulturore; Përcaktohen detyrimet dhe autorizimet e pronarit dhe të poseduesit të saj; Përcaktohet kryerja e punëve dhe ndërmarrja e masave administrative, inspektuese; Përcaktohet organizimi për mbrojtjen dhe për ruajtjen e trashëgimisë kulturore, Përcaktohet financimi i mbrojtjes, i ruajtjes dhe i prezantimit të saj; Rregullohet qasja e publikut dhe përcaktohen edhe çështje të tjera për mbrojtjen dhe për ruajtjen e trashëgimisë kulturore.

Në fund, zëvendësministrja Krasniqi i ftoi deputetët e Kuvendit ta miratonin këtë projektligj

Alush Gashi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, tha se është i zhgënjyer me cilësinë e tekstit të këtij projektligji.

A propozoi **t’i kthehet** ky projektligj Qeverisë së Kosovës, për rihartim.

Dritë Statovci, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, paraqiti vërejtje serioze në këtë projektligj.

Ajo propozoi **t’i kthehet** sponsoruesit ky projektligj për rihartim.

Gjylnaze Sylja, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, shprehu pakënaqësi me këtë projektligj dhe propozoi që ai **t’i kthehet** sponsoruesit.

Kryetari e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji.

Kuvendi, me shumicë votash

V E N D O S I

T’ia kthejë Qeverisë së Kosovës Projektligjin për Trashëgiminë Kulturore, për rihartim.

16. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Teatrin

Kryetari e ftoi sponsoruesin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Zëvendësministrja **Angjelina Krasniqi**, në emër të Qeverisë së Kosovës, arsyetoi nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri, si dhe qëllimin dhe objektivat që do të realizohen me zbatimin e tij.

Në vazhdim, Zëvendësministrja Angjelina Krasniqi theksoi se me këtë projektligj përcakton bazat dhe parimet e organizimit, drejtimit dhe zhvillimit të teatrit si formë e të shprehurit artistik, dhe të zhvillimit të sistemit teatror ë Kosovë; Është përcaktuar mënyra e menaxhimit të teatrit punët, dhe përgjegjësitë e drejtorit të teatrit të bordit artistik.

Me këtë Projektligj Teatri Kombëtar i Kosovës dhe teatrot kombëtare ai i Gjakovës dhe ai i Gjilanit bëhen teatro me asamble rezidente dhe realizojnë repertor të verifikuar dhe të qëndrueshëm artistike dhe obligohen që shfaqjet e tyre t'i distribuojnë edhe nëpër teatrot tjera të Kosovës.

Dispozitat ligjore për qeverisjen e Teatrit Kombëtar aplikohen po ashtu në mënyrë përkatëse edhe në organizimin dhe funksionalizimin e teatrove tjera publike, ndërsa për teatrot private dhe trupave teatrorë është lënë hapësirë më fleksibile si në procedurën e formimit të tyre ashtu edhe për ushtrimin e veprimtarisë së tyre teatrore.

Me këtë Projektligj parashihen edhe format e financimit të veprimtarive teatrore në Kosovë.

Me këtë projektligj rregullohet edhe statusi i Shtëpive të Kulturës, të cilat shndërrohen në Qendra të Kulturës dhe Artit.

Në fund, zëvendësministrja Krasniqi i ftoi deputetët e Kuvendit ta miratonin këtë projektligj

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Sabri Hamiti, Sala Ahmeti, Myrvete Dreshaj, Mahir Jakxhillar, Niman Alimusa, Hatixhe Hoxha, Fadil Geci dhe Sanije Zeqiraj**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Kryetari e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për -----66;

Kundër----- 0;

Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës, njëzëri e miratoi në parim Projektligjin për Teatrin. Kuvendi i ngarkoi komisionet kryesore dhe Komisionin për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sporte – Komision raportues - ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda tri javësh dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportet me rekomandime për miratim.

Kryetari e deklaroi seancën të mbyllur në orën 15:45 minuta.

E premte, 28 janar 2005

Vazhdim i seancës

Seancën e kryesoi Nexhat Daci, kryetari Kuvendit të Kosovës, kurse e ndihmoi Xhavit Haliti, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 85 deputetë dhe e shpalli të hapur punën e saj.

17. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për miratimin e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës dhe të Përvetësimeve për periudhën kohore prej 1 janarit deri më 31 dhjetor 2005.

Kryetari e ftoi sponsoruesin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri **Haki Shatri**, në emër të Qeverisë së Kosovës, arsyetoi nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri, si dhe qëllimin dhe objektivat që do të realizohen me zbatimin e tij.

Në vazhdim, ministri Shatri tha se të hyrat buxhetore të projektuara edhe për këtë vit janë të hyra nga burimet vetanake dhe kapin shumën prej 626 milion euro. Ngarkesa e bruto produktit me obligime fiskale sillet rreth 32% dhe krahasuar me vendet për rreth dhe të rajonit konsiderohet e ulët. Ky vëllim i të hyrave buxhetore paraqet rritje të hyrash për 2.3% në krahasim me vitin paraprak. Në strukturën e të hyrave buxhetore të hyrat tatimore marrin pjesë 84.5%, të hyrat jotatimore 9.8% dhe të hyrat vetanake të komunave 5.7%.

Vëllimi i mjeteve buxhetore që do të shpenzohen në këtë vit është 713.9 milion euro dhe paraqet një zvogëlim të shpenzimeve buxhetore në krahasim me vitin paraprak për 4%. Ndryshimi ndërmjet të hyrave buxhetore për 626 milion dhe shpenzimeve 713.9 milion do të mbulohet nga rezervat e krijuara në periudhën 2000 – 2003 në masë prej 88 milion euro, shumë kjo e cila araqet deficitin buxhetor të projektuar me këtë projektbuxhet për vitin 2005.

Struktura e shpenzimeve buxhetore sipas këtij projektbuxheti janë organizatat buxhetore me kompetenca të bartura që do të shpenzojnë 331 milion euro, organizatat buxhetore me kompetenca të rezervuara 208.3 milion euro dhe organizatat - komunat do të shpenzojnë 174.6 milion euro.

Në shpenzimet e gjithmbarshme kategoria e pagave dhe shpenzimet kapitale marrin pjesë në rreth 30%, pastaj subvencionet me 20%, mallrat dhe shërbimet 18% dhe rezervat me 2%.

Një kategori, e cila jashtë çdo rekomandimi profesional, na imponohet në shpenzimet buxhetore, janë ndërmarrjet publike : KEK-u, Aeroporti, Hekurudha dhe Ngrohja.

Organizatat buxhetore tjera që kanë prioritet në shpenzime buxhetore janë: Shërbimi Policor, Drejtësia, TMK-ja, Burgjet dhe Doganat.

Në këtë vit buxhetor do të fillohet dhënia e huajës e jo të subvencionimit për disa kategori të ndërmarrjeve publike, si për Aeroportin dhe një pjesë e investimeve në Korporatën Elektroenergjetike.

Ministri Shatri i paraqiti edhe disa propozime, në formë të amendamenteve, për plotësimin e këtij projektligji.

Në përfundim të arsyetimit, ministri Shatri i ftoi deputetët e Kuvendit ta miratonin këtë projektligj.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Alush Gashi, Demir Lima, Gjylnaze Syla, Veton Surroi, Naser Osmani, Emrush Xhemajli, Gani Koci, Behxhet Brajshori, Sabit Rrahmani, Bajrush Xhemajli, Fatmir Rexhepi, Nazim Jashari, Safete Hadërgjonaj, Fadil Kryeziu, Sabri Hamiti, Hydajet Hyseni dhe Ragip Zekolli**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Kryetari e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për -----55;
Kundër-----26;
Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës, njëzëri e **miratoi në parim** Projektligjin Projektligjit për miratimin e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës dhe të Përvetësimeve për periudhën kohore prej 1 janarit deri më 31 dhjetor 2005.

Kuvendi i ngarkoi komisionet kryesore dhe Komisionin për Buxhet dhe Financa – Komision raportues - ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda tri javësh dhe t’ia paraqesin Kuvendit raportet me rekomandime për miratim.

18. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave

Kryetari e ftoi sponsoruesin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Zëvendëskryeministri, Adem Salihaj, në emër të Qeverisë së Kosovës, arsyetoi nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri, si dhe qëllimin dhe objektivat që do të realizohen me zbatimin e tij.

Në vazhdim, zëvendëskryeministri Salihaj e shpjegoi strukturën e këtij projektligji.

Me këtë projektligj rregullohet mënyra e organizimit dhe e funksionimit të Komisionit të Pavarur të Mediave dhe i Transmetimit në Kosovë.

Projektligji është i përpiluar si vijon:

Në kreun e parë parashihen përkufizimet e nocioneve të përgjithshme.

Në kreun e dytë përfshihen dispozitat që rregullojnë funksionimin e Komisionit të Pavarur të Mediave dhe autorizimet e përgjithshme; Funkzionet e Këshillit, përbërja, shkarkimi nga Këshilli; Zyra e drejtorit ekzekutiv.

Në kreun e tretë parashihen dispozitat për licencimit të transmetuesve, aplikacionet për licencë të transmetimit dhe ripërtëritja e tyre, tarifatat vjetore të licencës, reklamimi dhe kërkesat për raportim, si dhe për shkeljen e kushteve të licencës dhe sanksionet.

Në kreun e katërt përfshihen dispozitat për themelimin e Bordit të mediave për ankesa, procedurat e bordit, paraqitjen e ankesave, vendimet e bordit dhe buxhetin.

Në kreun pestë përfshihen dispozitat për financimin e Komisionit të Pavarur të Mediave dhe të Bordit të Mediave për Ankesa.

Në kreun e gjashtë përfshihen dispozitat kalimtare dhe të fundit.

Në fund, zëvendëskryeministri i ftoi deputetët e Kuvendit ta miratonin këtë projektligj.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Ilaz Pireva, Hajredin Hyseni, Mirvete Dreshaj, Sabri Hamiti, Zylfi Merxha, Lulzim Zeneli, Numan Baliq, Nexhat Rexha, Sabit Rrehmani, Kamber Kamber, Qibrije Hoxha, Ramadan Musliu dhe Gjergj Dedaj**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Në mungesë të kuorumit, kryetari e deklaroi seancën të mbyllur.

E hënë, 31 janar 2005

Vazhdim i seancës

Seancën e kryesoi **Nexhat Daci**, kryetari i Kuvendit, kurse e ndihmoi **Xhavit Haliti**, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 75 deputetë dhe e shpalli të hapur punën e saj.

Kryetari e hodhi në votë miratimin e këtij Projektligji për Komisionin e Pavarur të Mediave. Rezultati ishte si vijon:

Për -----56;
Kundër-----19;
Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës e miratoi në parim Projektligjin për Komisionin e Pavarur të Mediave.

Kuvendi i ngarkoi komisionet kryesore dhe Komisionin për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media – Komision raportues - ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda tri javësh dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportet me rekomandime për miratim

19. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 2003/2 “Për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësiive”

Kryetari e ftoi sponsoruesin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri **Haki Shatri**, në emër të Qeverisë së Kosovës, arsyetoi nevojën për ndryshimin dhe plotësimin e këtij ligji.

Në vazhdim, ministri Shatri tha se ndryshimet e propozuara në këtë ligj kanë të bëjnë vetëm me një nen, përkatësisht pikëm 1 të nenin 21, që konsistojnë në rastet e veçanta kur zgjedhjet nacionale mbahen në periudhën më të shkurtër se 4 muaj, para fillimit të vitit fiskal buxhetor, siç ishte rasti me zgjedhjet e fundit të 23 tetorit 2004. Në ato rrethana nuk kishte mundësi objektive të shqyrtohet dhe miratohet buxheti i vendit. Prandaj, me ndryshimet e propozuara mundësohet vazhdimi për dy muaj i Ligjit të buxhetit, nga viti paraprak.

Pjesa tjetër e nenit 21 nuk ndryshohet, prandaj propozoj që ky projektligj të miratohet.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Fatmir Rexhepi, Gani Koci, Naser Osmani, Xhevdet Neziraj, Jakup Krasniqi dhe Behxhet Brajshori**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Kryetari e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për -----60;
Kundër-----20;
Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës e miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 2003/2 “Për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësive”. Kuvendi i ngarkoi komisionet kryesore dhe Komisionin për Buxhet dhe Financa – Komision raportues - ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda tri javësh dhe t’ia paraqesin Kuvendit raportet me rekomandime për miratim.

20. Shqyrtimi i propozimvendimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e kryetarit të Komisionit Rregullativ për Prokurim Publik.

Qeveria e Kosovës e kishte propozuar z. Ilaz Dula për kryetar të Komisionit Rregullativ për Prokurim Publik.

Kryetari e hodhi në votë propozimin Qeverisë. Rezultati ishte si vijon:

Për-----60;
Kundër----- 22;
Abstenime-----0.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, emëroi z. **Ilaz Dulla, kryetar** të Komisionit Rregullativ për Prokurim Publik.

Kryetari e deklaroi seancën të mbyllur në orën 11:35 minuta.

Përgatitur nga

Spektori për Çështje Plenare dhe Procedurale

Kryetari i Kuvendit të Kosovës
Akademik **Nexhat DACI**
